

# RAPORT

## I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e Studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri kompjuterike dhe teknologji informacioni", me profile: "Inxhinieri kompjuterike dhe BIG Data"; "Rrjetet kompjuterike dhe Siguria Kibernetike"; "Multimedia-Dizajn", Kolegji Univesitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë"

**Ekspertet e vlerësimi: të jashtëm:**

Prof. Asoc. Elinda Kajo Mece



Prof. Asoc. Ana Ktona




Korrik/2019

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Për Programin e studimit "Master i shkencave" në "Inxhinieri kompjuterike dhe teknologji informacioni", me profile: "Inxhinieri kompjuterike dhe BIG Data"; "Rrjetet kompjuterike dhe Siguria Kibernetike"; "Multimedia-Dizajn"**

Nr.	Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit	
1	IAL Aplikues:	Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Ekonomisë/ Departamenti i Inxhinierisë Softuerike
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Urdhër MAS Nr. 565, datë 02.12.2016 (bazuar në VKA Nr. 194, datë 17.10.2016)
4	Titulli i programit të studimit:	Master i shkencave në "Inxhinieri kompjuterike dhe teknologji informacioni", me profile: "Inxhinieri kompjuterike dhe BIG Data", "Rrjetet kompjuterike dhe Siguria Kibernetike", "Multimedia-Dizajn"
5	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
7	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
10	Programi ofrohet nga institucioni	Po
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7
15	Aktivizimi i programit të studimit	2017-2018
16	Brezi i parë i diplomimit të studentëve	2018-2019
17	Numri i studentëve	38 studentë



## HYRJE

**Të dhëna për programin e studimit "Master i shkencave" në "Inxhinieri kompjuterike dhe teknologji informacioni", me profile: "Inxhinieri kompjuterike dhe BIG Data"; "Rrjetet kompjuterike dhe Siguria Kibernetike"; "Multimedia-Dizajn" dhe Kolegjin Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë"**

Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" është licencuar në vitin 2011 me Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 781, datë 10.11.2011, me emërtimin Shkolla e Lartë Universitare Private "Instituti Kanadez i Teknologjisë" që organizohet në dy Fakultete:

- 1. Fakultetin e Ekonomisë** i cili ofron programet e studimit të ciklit të parë *Administrim biznesi dhe Administrim biznesi dhe Teknologji informacioni*, dhe
- 2. Fakultetin e Inxhinierisë** që do të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë *Inxhinieri Softuerike dhe Inxhinieri industriale*.

Këto programe studimi zgjasin 3 vjet dhe në përfundim studentët fitojnë 180 kredite (ECTS).

Institucioni ka marrë lejen e ushtrimit të aktivitetit në përputhje me licencën e dhënë me Urdhër Nr. 68, datë 27.02.2012 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

Shkolla e Lartë Universitare Private "Instituti Kanadez i Teknologjisë" është akredituar me Urdhër Nr. 139, datë 25.03.2016 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në përputhje me Vendimin Nr. 92, datë 02.11.2015 të Këshillit të Akreditimit.



Me Urdhër Nr. 556, datë 24.11.2016 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit është miratuar Statuti i institucionit Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë", në përputhje me Ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" (sipas Vendimit të Senatit Akademik Nr. 69, datë 21.09.2016 të Institucionit).

Gjithashtu, KU "Instituti Kanadez i Teknologjisë" ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me agjencinë Britanike të sigurimit të cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 116, datë 15.12.2017 dhe Institucioni është akredituar me kohëzgjatjen 5 vite, me afat vlefshmërie deri në 14.12.2022 duke marrë "Certifikatën e Akreditimit" e vlefshme për këtë periudhë akreditimi.

Për vitin akademik 2018-2019, KU "Instituti Kanadez i Teknologjisë" ofron 11 programe studimi të dy cikleve, përkatësisht: 6 programe studimi të ciklit të parë "Bachelor" dhe 5 programe studimi të ciklit të dytë "Master i shkencave".

Programi i studimit Master i shkencave në "Inxhinieri kompjuterike dhe teknologji informacioni", me profile: "Inxhinieri kompjuterike dhe BIG Data"; "Rrjetet kompjuterike dhe Siguria Kibernetike"; "Multimedia-Dizajn" është licencuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 565, datë 02.12.2016 dhe është vlerësuar nga Agjencia në kuadër të licencimit me VKA Nr. 189, datë 07.07.2016, me kushte dhe me vendim KA për heqjen e kushteve në kuadër të licensimit: VKA Nr. 194, datë 17.10.2016.

Në vlerësimin e parë, me Vendim Nr. 189, datë 07.07.2016, Këshilli i Akreditimit shprehet që programi të hapet pasi të plotësojë këto mangësi:



- a. Të korrigojen mospërputhjet e aktiviteteve në planin mësimor dhe syllabuseve përkatëse përsa I përket orëve mësimore të lëndëve sipas formave të mësimdhënies si dhe të jepet ngarkesa në orë për projektin e parashikuar sipas planit mësimor.
- b. Të realizohet një përkthim më i mirë në shqip i disa emërtimeve të lëndëve si dhe i terminologjisë së përdorur do të përmirësonte dokumentacionin e paraqitur.
- c. Të rishikohet mbulimi i ngarkesës mësimore për rastin kur për 5 lëndë është parashikuar I njëjti pedagog.
- d. Të jepen të dhëna për infrastrukturën në dispozicion të programit (informacion lidhur me: auditorët, laboratorët e duhur, bibliotekën, mjetet kompjuterike, etj.) si dhe për personelin ndihmës mësimor shkencor dhe administrative në shërbim të programit të studimit.
- e. Të jepen të dhënat për bashkëpunimet e mundshme për realizimin e praktikave mësimore.
- f. Rekomandohet vendosja e një note mesatare minimale për pranimet.

Në vlerësimin e dytë, me Vendim Nr. 194, datë 17.10.2016, Këshilli i Akreditimit shprehet se janë plotësuar kushtet dhe rekomandimet e lëna dhe i rekomandon Ministrin të Arsimit dhe Sportit hapjen e programit të studimit "Master i shkencave" në "Inxhinieri kompjuterike dhe teknologji informacioni", me profile: "Inxhinieri kompjuterike dhe BIG Data"; "Rrjetet kompjuterike dhe Siguria Kibernetike"; "Multimedia-Dizajn".



Programi i studimit Master i shkencave në "Inxhinieri kompjuterike dhe teknologji informacioni", me profile: "Inxhinieri kompjuterike dhe BIG Data"; "Rrjetet kompjuterike dhe Siguria Kibernetike"; "Multimedia-Dizajn" ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë Softuerike, Fakulteti i Inxhinierisë, KU "Instituti Kanadez i Teknologjisë". Programi është aktivizuar për herë të parë në vitin akademik 2017-2018 dhe në vitin akademik 2018-2019 mbyllet një cikël i aktivizimit të tij dhe institucioni pritet të diplomojë brezin e parë të studentëve. Aktualisht, janë 38 studentë të regjistruar dhe që ndjekin studimet në vitin e parë dhe të dytë në këtë program studimi.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) është hartuar në vijim të detyrimeve për akreditimin e programit të studimit të ciklit të dytë "Master i shkencave" në "Inxhinieri kompjuterike dhe teknologji informacioni", me profile: "Inxhinieri kompjuterike dhe BIG Data"; "Rrjetet kompjuterike dhe Siguria Kibernetike"; "Multimedia-Dizajn", ofruar nga KU "Instituti Kanadez i Teknologjisë". Në hartimin e këtij Raporti, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është mbështetur në dokumentacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit të përgatitur nga Grupi i Vetëvlerësimit për këtë program studimi, në konstatimet, gjetjet dhe shënimet e mbajtura gjatë takimeve të zhvilluara gjatë vizitave në Institucion, si dhe në dokumentacionin shtesë në kuadër të tyre.

## **GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)**

Përbërja e GVJ: Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Prof. Asoc. Elinda Kajo Meçe dhe Prof. Asoc. Ana Ktona si ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi. Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL: Znj. Emisa Isufaj.

Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" (KU "IKT") është njohur me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 02.07.2019, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të

shkresës me Nr. 133/10 Prot., datë 02.07.2019. KU “IKT” përcjell në ASCAL nëpërmjet shkresës me Nr. 413/1 Prot., datë 08.07.2019 komentet për dy konkluzione në draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm.

*Komentet e IAL:*

**1. Për konkluzionin e Kapitullit nr. 2:**

**Draft - Raporti:** “GVJ evidenton se numri minimal i personelit akademik me kohë të plotë në departamente dhe si rrjedhojë dhe në Fakultetin e Inxhinierisë, do ta çoj në vështirësi institucionin në rast të lëvizjes së stafit akademik”

**KU “IKT”:** Fakulteti i Inxhinierisë ka tre njësi bazë dhe secila prej tyre është e përbërë nga së paku 7 anëtarë për një total prej 21 antarësh me kohë të plotë. Nisur nga fakti se disa programe janë hapur rishtazi, institucioni vlerëson në mënyrë të vazhdueshme (çdo fund viti akademik) nevojat për staf sipas ngarkesës së parashikuar për vitin e ardhshëm akademik. Vendet e lira të punës publikohen në periudhën maj/qershor. Kjo i jep institucionit kohë të mjaftueshme për procesin e punësi it, plotësimit të kapaciteteve që i duhen, si dhe fillimin e procesit arsimor akademik në muajin tetor.

**Draft – Raporti:** “GVJ konstaton se me rritjen e numrit të studentëve do ta bënte të vështirë menaxhimin efikas të ambienteve edhe pse gjatë gjithë ditës, dhe si rrjedhojë do të kërkojë hapësira të reja.”

**KU “IKT”:** KU “IKT” duke qënë një intitucion i vogël, siç përcakton edhe në strategjinë e vet, ka zgjedhur të rritet gradualisht. Për këtë arsye dhe mbështetur gjithnjë mbi nevojat që ka institucioni, janë marrë masat çdo vit akademik që institucioni të zgjerohet në propocion me prurjet apo realizimn e kuotave. KU “IKT” i ka të gjitha mundësitë që të zgjerohet në godinën ekzistuese, por synimi për një rritje graduale, e ka bërë që të jetë i matur në këtë aspekt.

Ekspertët e Vlerësimit u njohën me përgjigjen e IAL dhe vendosën t’i qëndrojnë konkluzioneve të formuluar në draft – RVJ.



## 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Bazuar në RVB dhe në dokumentacionin e programit të studimit "Master i shkencave" në "Inxhinieri kompjuterike dhe teknologji informacioni", me profile: "Inxhinieri kompjuterike dhe BIG Data"; "Rrjetet kompjuterike dhe Siguria Kibernetike"; "Multimedia-Dizajn", gjejmë të përcaktuar misionin dhe objektivat e ndara sipas profileve [RVB fq 57,58; dok "Rregullore e programit të studimit Msc. Inxh.Kompjuterike dhe IT shqip-anglisht"].



Profili "*Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike*" ofrohet për studentët e diplomuar që dëshirojnë të punësohen në kompani që kërkojnë njohuri dhe aftësi të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit kompjuterik; të sistemeve operative të sigurta, të aplikacioneve të sigurta, apo të vazhdojnë doktoraturën në fushën e sigurinë së informacionit. Gjithashtu, të kuptojnë se si zhvillohet një politikë e sigurisë dhe si politikat drejojnë vendimet teknologjike, bazuar në njohuritë teorike dhe punës laboratorike në fushën e sigurisë së informacionit.

Profili "*Inxhinieri Kompjuterike dhe Big Data*" është i përcaktuar për studentët me baza të forta në matematikë, shkencat kompjuterike, dhe statistikë të aplikuar. Programi ka si objektiv të sigurojë teorinë dhe metodat themelore të kërkimit të të dhënave, duke plotësuar nevojën e tregut të punës me profesionistë në fushën e të dhënave.

Profili "*Inxhinieri Kompjuterike dhe Multimedia Dizajn*" ofron njohuri kompjuterike, njohuri në fushën e komunikimit interaktiv, përdorimin e teknikave për vizualizimin e të dhënave dhe krijimin e ndërfaqeve të sistemeve kompjuterike. Programi ka si objektiv të formojë inxhinierë me aftësi për projektim dhe ndërtim të ndërfaqeve softuere, për të gjitha platformat celulare, tabletë, desktopët, TV dhe pajisjet tjera.

Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se plani mësimor i programit të studimit master i shkencave në Inxhinieri Kompjuterike, nuk kishte patur asnjë ndryshim apo përditësim. Në takimim me drejtuesit e Departamentit, Fakultetit dhe Rektorin, rishikimi i planit mësimor lidhej me faktin e akreditimit me të njëjtin plan mësimor.

Programi i studimit "Master i shkencave" në "Inxhinieri kompjuterike dhe teknologji informacioni", me profile: "Inxhinieri kompjuterike dhe BIG Data"; "Rrjetet kompjuterike dhe Siguria Kibernetike"; "Multimedia-Dizajn" është në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të KU IKT [dok. Strategjia e



Zhvillimit të KU IKT 2024] dhe planin strategjik të biznesit [dok. Plani Strategjik dhe Biznes Plani i KU IKT 2012]. Në lidhje me studimin e tregut, ekziston një studim feashibiliteti në 2011 [dok. Studimi i tregut 2011- Feasibility Study 2011], dokumenti ishte përfshirë në listën e dokumentave në sistemin e ASCAL, Gjatë vizitës GVJ, ju deklarua se ka edhe një studim të tregut për këtë program studimi, dokumenti i cili paraqet në fakt projektin dhe planet financiare të programit të studimit, është një nga dokumentat e marrë gjatë vizitës. [dok. Studimi i tregut për programin MSc në CE\_IT, Msc Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni, Kolegji Universitar Insituti Kanadez i Teknologjise].

Në vitin akademik 2017-2018 programi ka pasur 19 studentë të regjistruar. Staf i angazhuar në këtë program studimi ka qenë 9 pedagoge, nga të cilët 1 Prof. Dr. 1 Prof.Asoc, 7 Doktor Shkencash, prej të cilëve 6 PAE dhe 3 PAK. Në vitin akademik 2018-2019 janë regjistruar 22 studentë (2 prej tyre janë ç' regjistruar) dhe në programin e studimit janë angazhuar 13 pedagogë, nga të cilët 9 Doktor Shkencash, 2 Prof.Asoc. dhe 2 Prof. Dr., prej të cilëve 8 PAE dhe 5 PAK.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Programi i studimit "Master i shkencave" në "Inxhinieri kompjuterike dhe teknologji informacioni", me 3 profile, është i hartuar nga Departamentit të Inxhinierisë Softuerike, Fakulteti i Inxhierisë dhe është në përputhje me misionin dhe qëllimin e KU IKT.</p> <p>Programi i studimit ka objektiva të qarta në lidhje me formimin profesional të studentëve, aftësimin e tyre teorik dhe praktik si edhe në fushën e kërkimit shkencor.</p> <p>Ky program ka një mision dhe qëllim të qartë për formimin e studentëve.</p> <p>Ka një studim feashibiliteti të realizuar në 2011[dok. Studimi i tregut 2011- Feasibility Study 2011]. Ka studim tregu, Janar 2016, të lidhur me programin e studimit [dok. Studimi i tregut për programin MSc në CE_IT, Msc Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni, Kolegji Universitar Insituti Kanadez i Teknologjise]. i cili është hapur në 2017. Studimi i tregut i vitit 2016, jep të dhëna mbi programet bachelor dhe master të ofruara në fushën e Inxhinierisë kompjuterike dhe Teknologjisë së Informacionit në IAL publike dhe private, mundësitë</p>

	<p>e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; apo edhe numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet e tjera.</p> <p>Ky dokument paraqitet më tepër si projekti dhe planet financiare të programit të studimit.</p> <p>Fushat që mbulon ky program studimi janë në përputhje me kërkesat e tregut, me progresin dhe strategjitë e zhvillimit ekonomik të vendit.</p> <p>Programi i studimit “Master i shkencave” në "Inxhinieri kompjuterike dhe teknologji informacioni", me 3 profile, ruan vlerat kombëtare dhe kulturore të vendit.</p>
<p><b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Programi i studimit “Master i shkencave” në "Inxhinieri kompjuterike dhe teknologji informacioni", me profile: "Inxhinieri kompjuterike dhe BIG Data"; "Rrjetet kompjuterike dhe Siguria Kibernetike"; "Multimedia-Dizajn" është në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të KU IKT [dok. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024] dhe planin strategjik të biznesit [dok. Plani Strategjik dhe Biznes Plani i KU IKT 2012].</p>
<p><b>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Programi i studimit “Master i shkencave” në "Inxhinieri kompjuterike dhe teknologji informacioni", me profile: "Inxhinieri kompjuterike dhe BIG Data"; "Rrjetet kompjuterike dhe Siguria Kibernetike"; "Multimedia-Dizajn" është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga kuadri ligjor.</p> <p>Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>
<p><b>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>KU IKT ka një plan strategjik të përcaktuar [dok. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024] mbi bazën e të cilit vepron Fakulteti i Inxhinierisë për përmirësimin e programeve mësimore.</p> <p>Departamenti i Inxhinierisë Softuerike, bënë vazhdimisht përpjekje në përmirësimin e mësimdhënies dhe cilësisë përmes përdorimit të</p>



instrumentave të kontrollit dhe vlerësimit.

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Programi i studimit "Master i shkencave" në "Inxhinieri kompjuterike dhe teknologji informacioni", me profile: "Inxhinieri kompjuterike dhe BIG Data"; "Rrjetet kompjuterike dhe Siguria Kibernetike"; "Multimedia-Dizajn", ofruar nga Departamenti Inxhinierise Softuerike, Fakulteti i Inxhinierisë, është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, është në përputhje me misionin, objektivat dhe strategjinë e zhvillimit të KU IKT si dhe kërkesat e tregut të punës për specialistë në fushat që mbulojnë tre profilet. Fakulteti i Inxhinierisë e ka në praktikë pune rishikimin e planeve mësimorë, por për programin e studimit "Master i shkencave" në "Inxhinieri kompjuterike dhe teknologji informacioni", me profile, nuk kishte realizuar asnjë rishikim apo përditësim, në mënyrë që procesi i akreditimit të programit të studimit të bëhet me të njëjtin plan mësimor që ka filluar, sipas kërkesave ligjore të përcaktuara.

**2. Struktura akademike e Fakultetit (Departamentit përgjegjës për programin e studimit)**

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit



Bazuar në RVB[fq.18] [dok. Organigrama e KU "IKT" 2016] dhe konfirmimit gjatë vizitës në Institucion, KU "Instituti Kanadez i Teknologjisë" është i organizuar në dy Fakultete:

- **Fakulteti i Inxhinierisë**
- **Fakulteti i Ekonomisë**

**Fakulteti i Inxhinierisë** përbëhet nga këto njësi:

1. Departamenti i Inxhinierisë Softuerike
2. Departamenti i Inxhinierisë Industriale
3. Njësia e Kërkimit Shkencor "CIRD Inxhinieri"

**Fakulteti i Ekonomisë** përbëhet nga këto njësi:



1. Departamenti i Administrimit të Biznesit
2. Departamenti i Administrimit të Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit
3. Njësia e Kërkimit Shkencor "CIRD Ekonomi".

Detyrat, funksionet, përgjegjësitë dhe procesi i vendimmarrjes është përcaktuar në Statut [ dok. Statuti i KU "IKT" 2016], Rregullorja Institucionale [dok. Libri i rregulloreve të institucionit].

Të gjitha departamentet përbëhen nga 7 personel akademik të punësuar me kohë të plotë, prej të cilëve të paktën tre kanë gradë ose titull.

Programet Akademike që ofrohen nga Fakulteti i Inxhinierisë

Cikli i parë i studimeve, Bachelor me 180 kredite:

- Inxhinieri softuerike
- Inxhinieri industriale
- Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni

Cikli i Dytë i Studimeve, Master i Shkencave me 120 kredite:

- Inxhinieri softuerike
- Inxhinieri industrial
- Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni me tre profile

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**


##### **Struktura akademike e Fakultetit (organigrama)**

[dok. Organigrama e KU "IKT" 2016]

##### **Personeli akademik për çdo njësi bazë: PAE, PAK, PA, titujt/gradat**

Tabelat Nr 1,2 në Aneks. Të dhënat janë paraqitur për dy vitet akademike të programit të studimit, GVJ evidenton se numri i personelit akademik është në minimumin e ekzistencës së tij 7, gjë që e bën departamentin, që ofron këtë program studimi të jetë në vështirësi për çfarëdo arsye të lëvizjes së stafit akademik.

#### **Vlerësimi sipas Standardeve**



Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardevë
<b>Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>KU “IKT” është organizuar në mënyrë që të përmbushë misionin e tij.</p> <p>KU IKT përbëhet prej dy fakulteteve: Fakultetit të Inxhinierisë dhe Fakultetit të Ekonomisë. Fakultetet ndahen në departamente dhe njësi kërkimore të cilat i shërbejnë zhvillimit të procesit mësimor kërkimor.</p> <p>Fakulteti i Inxhinierisë është i përbërë nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Inxhinierisë Softuerike</li> <li>2. Departamenti i Inxhinierisë Industriale</li> <li>3. Njësia e Kërkimit Shkencor "CIRD Inxhinieri"</li> </ol> <p>Departamenti i Inxhinierise Softuerike ka në përbërje të tij të 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 janë me grada dhe tituj.</p> <p>Lista e stafit akademik dhe titujt shkencor të secilit jepen në tabelat ne aneks. . Të dhënat janë paraqitur për dy vitet akademike të programit të studimit, ku vihet re se numri i personelit akademik është në minimumin e ekzistencës së tij 7, gjë që e bën departamentin, që ofron këtë program studimi të jetë në vështirësi për çfarëdo arsye të lëvizjes së stafit akademik.</p>
<b>Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Fakulteti Inxhinierisë dhe Departamenti i Inxhinierisë Softuerike apo njësia e kërkimit shkencor kanë të përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrat në Statut [dok.Statuti i KU IKT] dhe në Rregulloren e Institucionit, [dok. Libri i Rregulloreve Institucionale], të cilat janë reflektuar këto dy vite të veprimtarisë së programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni.</p> <p>Departamenti dhe Fakulteti përfshihen në procesin e rekrutimit në bazë të rregullores mbi “Politikat dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik” [dok . Politikat dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik]</p>
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b>	
<p>KU IKT është një institucion i organizuar në dy Fakultete, Fakulteti i Inxhinierisë dhe Fakulteti i Ekonomisë. Fakulteti i Inxhinierisë përbëhet nga Departamenti i Inxhinierisë Softuerike, Departamenti i Inxhinierisë Industriale dhe Njësia e Kërkimit Shkencor "CIRD Inxhinieri". Departamenti i Inxhinierisë Softuerike, i cili është përgjegjës për programin e studimit “Master i shkencave” në Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni, me tre profile si dhe Fakulteti i Inxhinierisë, janë të qartë për kompetencat, përgjegjësitë dhe detyrat që kanë, për realizimin e programit të studimit “Master i</p>	

shkencave” në Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni me tre profile. Departamenti Inxhinierise Softuerike dhe Fakulteti i Inxhinierisë, janë përfshirë në procesin e punësimit të personelit akademik dhe përdorin instrumenta të kontrollit të performancës së tyre. GVJ evidenton se numri minimal i personelit akademik me kohë të plotë në departamente dhe si rrjedhojë edhe në Fakultetin e Inxhinierisë, do ta çoj në vështirësi institucionin në rast të lëvizjes së stafit akademik.

### 3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Bazuar në të dhënat e paraqitura në RVB dhe tabelave mbi stafin akademik në Aneks, GVJ evidentoi se Fakulteti i Inxhinierisë ka në përbërje të tij 21 personel akademik me kohë të plotë, dhe 7 personel akademik me kohë të pjesshme [Tabela Nr. 2 në Aneks]. Departamenti i Inxhinierisë Softuerike ka në përbërje të tij 11 personel akademik, nga të cilët 7 PAE dhe 4 PAK. Në programin e studimit “Master i shkencave” në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni”, me profile janë të regjistruar 41 studentë (3 të ç’regjistruar). Raporti PAE/PAK për departamentin e Inxhinierisë Softuerike është 7/4. PAE përfaqëson 63.6% të personelit akademik të këtij departamenti 7/11, ndërsa në rang programi edhe pse raporti në numër është i njëjtë, **ngarkesa që mbulojnë PAE është në masën 63.64 % për vitin akademik 2017-2018 dhe 49.3 % për vitin akademik 2018-2019. GVJ konstatoi se ngarkesa mësimore që PAE mbulon në këtë program studimi, në vend që të shkonte drejt 70% është ulur më shumë, në masën 49,3% [ Tabela nr 20, 21 në Aneks].**

Personeli akademik dhe drejtuesit akademikë të këtij departamenti kryejnë veprimtari të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, shërbime për zhvillimin dhe sigurimin e cilësisë në IKT, këshillim për studentët, dhënien e ndihmës për studentët (tutorial) si dhe detyra administrative në funksion të mësimdhënies. Ngarkesa mësimore për personelin akademik varion nga një minimum prej 180 orë mësimore në vit akademik në maksimumin prej 300 orë mësimore në vit akademik [dok. Vendim i Senatit Akademik nr. 16 datë 11.10.2018 për limitet e ngarkesës akademike për vitin akademik 2018-2019] Mesatarja e ngarkesës mësimore vlerësohet rreth 205 orë mësimore për vit akademik. [ dok. Kontrate Pune me Kohe te Plote me afat] [dok. Kontrate Pune tip me Kohe te Plote pa afat]. Vlerësimi i performancës së stafit akademik është periodik dhe realizohet në bazë të procedurave të saktësuar në Librin e Rregulloreve [dok. Librin e Rregulloreve]. Ky vlerësim koordinohet nga zyra e Rektorit, Dekanit,

NJBSC si dhe zyra e Burimeve Njerëzore. [dok. Raporteve të vetvlerësimit të stafit akademik 2017-2018]. Vlerësimi nga studenti bëhet dy herë në vit nëpërmjet pyetësoreve.

Nga RVB dhe nga takimi me stafin akademik, mbajtur në datë 09.05.2019 ku ishin të pranishëm PAE dhe PAK, evidentohet se në programin “Master i shkencave” në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni” me tre profile, 2018-2019, viti i dyte i aktivizimit të tij, janë gjithsej 11 pedagogë në total të angazhuar, 7 prej tyre janë me kohë të plotë dhe 4 janë me kohë të pjesshme. Ngarkesa mësimore e planifikuar për këtë program studimi, nuk mbulohet nga personel akademik me kohë të plotë. Personeli akademik me kohë të plotë, i angazhuar gjatë vitit akademik 2018– 2019, përbën 63.6% të personelit akademik dhe mbulon 49.3 % të ngarkesës mësimore totale për realizimin e programeve të studimit.

Në këtë kuadër është e nevojshme që edhe në vazhdim të punohet për të rritur numrin e stafit akademik të brendshëm dhe qëndrueshmërinë e tij. Gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerëzore, GVJ konstatoi se dosjet e personelit akademik ishin të plota.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

**Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat.**

Për vitin akademik 2017-2018 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është **9 pedagogë gjithsej**, nga të cilët **6** janë Personel Akademik Efektiv (PAE), **3** janë Personel Akademik me Kontratë (PAK).

Për vitin akademik 2018-2019 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është **13 pedagogë gjithsej**, nga të cilët **8** janë Personel Akademik Efektiv (PAE), **5** është Personel Akademik me Kontratë (PAK).

Të dhënat paraqiten në Tabelat Nr. 4, 5 në Aneks

**Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit .**

Këshilli shkencor i programit të studimit “Master i shkencave” në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni” me tre profile përbëhet nga katër pedagogë: tre pedagogë me titull “Profesor” dhe një pedagog me gradën “Doktor i Shkencave”.

Të dhënat paraqiten në Tabelën Nr 3 në Aneks

**Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre .**

Për vitin akademik 2017-2018, nga **9** pedagogë të angazhuar gjithsej (6 - PAE dhe 3 - PAK): **1** pedagog ka titullin Profesor (PAE), **2** pedagogë kanë titullin “Profesor të Asociuar” (1 - PAE dhe 1 - PAK) dhe **6** (4 - PAE dhe 2 - PAK): kanë gradën “Doktor i Shkencave”.

Për vitin akademik **2018-2019**, nga **13** pedagogë të angazhuar gjithsej (8 - PAE dhe 5 - PAK): **2** pedagogë kanë titullin Profesor (PAE), **4** pedagogë kanë titullin “Profesor të Asociuar” (1 - PAE dhe 3 - PAK) dhe **7** kanë gradën “Doktor i Shkencave” (5-PAE dhe 3-PAK).

Të dhënat paraqiten në Tabelat Nr 4, 5 në Aneks

**Të dhënat sipas seksit. Të dhëna sipas moshës së personelit .**

Për vitin akademik **2017-2018**, nga **9** pedagogë të angazhuar gjithsej (6 - PAE dhe 3 - PAK): **5** i përkasin gjinisë femërore (3 - PAE dhe 2 – PAK) dhe 4 i përkasin gjinisë mashkullore (3 - PAE dhe 1 – PAK).

Për vitin akademik **2018-2019**, nga **13** pedagogë të angazhuar gjithsej (8 - PAE dhe 5 - PAK): **3** i përket gjinisë femërore (2-PAE dhe 1-PAK) dhe 10 i përkasin gjinisë mashkullore (6 - PAE dhe 4 – PAK).

Të dhënat paraqiten në Tabelat Nr 5,6 në Aneks.

**Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat .**

Personeli akademik dhe drejtuesit akademikë të këtij departamenti kryejnë veprimtari ne baze te kontrates [ dok. Kontrate Pune me Kohe te Plote me afat] [dok. Kontrate Pune tip me Kohe te Plote pa afat].Ngarkesa mësimore për personelin akademik percaktohet nga senati [dok. Vendim i Senatit Akademik nr. 16 datë 11.10.2018 për limitet e ngarkesës akademike për vitin akademik 2018-2019]

**Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë (Plotëso Tabelat ne aneks)**

Nga informacioni i mare në RVB dhe nga vizita në institucioni, në KU IKT, secili nga 2 fakultetet ka një personel administrativ (Sekretare). Meqënëse numri i studentëve është i vogël, detyrat administrative në funksion të mësimdhënies mbulohen nga stafi akademik.

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Tabelat e stafit akademik

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre; <b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	Ne KU IKT, personeli akademik, ndihmës, mësimor-shkencor dhe administrativ kryejnë veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për zhvillimin dhe sigurimin e cilësisë në IKT, këshillim për studentët, dhënie e ndihmës për studentët ,si dhe detyrat administrative në funksion të mësimdhënies. Angazhimi i personelit është në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe me

	strategjinë për zhvillimin KU IKT [dok. Manuali për Punonjësit e Fakultetit]
<b>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënljore në fuqi.</p>	<p>Stafi akademik i Departamentit të Inxhinierisë Softuerike përfshihet në hartimin e kurrikulave dhe organizimin e programit të studimit.</p> <p>Parimet, kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme si edhe përcaktimi i ngarkesës mesimore janë të përcaktuara në dokumentacionin bazë që rregullon veprimtarinë e IKT, në përputhje me aktet ligjore dhe nënljore në fuqi.</p>
<b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Në zyrën e Burimeve Njerëzore u verifikua informacioni në lidhje me procedurën e rekrutimit të personelit akademik dhe u verifikuan përmbajtjet e dosjeve të personelit akademik. Kontratat e përgatitura për personelin akademik bëhen në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe me Kodin e Punës. Procesi i rekrutimit është i hapur. Në Zyrën e Burimeve Njerëzore gjenden dosjet e personelit, në të cilat përfshihen edhe raportet e vlerësimit gjatë rekrutimit si dhe raportet e vlerësimit nga studentët. Personeli akademik me kohë të plotë, i angazhuar gjatë vitit akademik 2018– 2019, përbën 63.6% të personelit akademik dhe mbulon 49.3 % të ngarkesës mësimore totale për realizimin e programeve të studimit. Vlerësimi i performancës së personelit akademik në IKT bazohet në procedura të saktësuara në rregulloret e brendshme institucionale [dok.Libri i Rregulloreve Institucionale]</p>
<b>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Përgjegjëse e Departamentit të Inxhinierisë Softuerike është me gradën Doktor (PHD) , të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike.</p> <p>Bazuar në syllabuset e paraqitura konstatohet se titullarët e lëndëve dhe moduleve kanë të paktën gradën “Doktor”.</p> <p>Drejtuesit e KU IKT, dhe përgjegjësi i Departamentit të Inxhinierisë Softuerike, që janë përgjegjes për programin e studimit “Master i shkencave” në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni” me tre profile, janë të punësuar me kohë të plotë në institucion.</p> <p>Departamenti i Inxhinierisë Softuerike cakton personel akademik të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale</p>
<p><b>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë Softuerike cakton një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën për cdo student. Gjatë vizitës u konstatua se disa prej studentëve e vitit të dytë kishin tashmë të caktuar udhëheqësin e temës.</p> <p>Udhëheqësit e diplomave kanë të paktën gradën shkencore “Doktor” dhe nuk u evidentuan raste kur udhëheqësi mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht.</p> <p>Deri më tani nuk ka patur të diplomuar në programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni me tre profile.</p>
<p><b>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Fusha studimore-kërkimore në të cilën udhëheqësi është i specializuar është në fushën e inxhinierisë elektronike, kompjuterike dhe telekomunikacionit, gjithashtu rezulton se udhëheqësi është me eksperiencë në fushën e tij të kërkimit.</p>



<b>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>KU IKT angazhon një staf ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve praktike laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratoreve dhe ambientet si sallë interneti, salla e bibliotekës etj. Stafi akademik përveç mesimdhënies është i ngarkuar që të kryejë edhe detyra në shërbim të studentëve.</p>
<b>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Për Fakultetin e Inxhinierisë, ngarkesa mësimore për personelin akademik varion nga një minimum prej 180 orë mësimore në vit akademik në maksimumin prej 300 orë mësimore në vit akademik. Mesatarja e ngarkesës mësimore për personelin akademik vlerësohet të jetë 205 orë mësimore për vit akademik. Detyrat e personelit akademik, ngarkesa dhe format e saj përcaktohen në Kontratën e lidhur mes tij dhe KU IKT.</p> <p>Kontratrat janë në përputhshmëri me kuadrin ligjor dhe rregullativ të institucionit.[dok. Kontrate Pune me Kohe te Plote me afat] ,[dok. Kontrate Pune me Kohe te Plote pa afat]</p>
<b>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore në nivel institucional disponon: të dhëna të plota dhe të hollësishme në lidhje me personelin akademik të angazhuar në mesimdhënie; listën e plotë të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme të angazhuar në mesimdhënie për çdo semestër dhe vit akademik. Lista e stafit me kohë të pjesshme aprovohet në senat, sipas propozimeve të fakulteteve përkatëse çdo vit akademik. Kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik dhe ndihmës publikohen në Web Site e KU IKT</p>
<b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b>	
<p>Fakulteti i Inxhinierisë dhe Departamenti i Inxhinierisë Softuerike angazhon një personel akademik efektiv dhe me kontratë. Angazhimi i personelit është në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe me strategjinë për zhvillimin e institucionit. Mësimdhënia i nënshtrohet një proces vlerësimi periodik. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë nuk mbulon 70% të ngarkesës mësimore totale për realizimin e programit të studimit. GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë, i angazhuar gjatë vitit akademik 2018– 2019, përbën 63.6% të personelit akademik dhe mbulon 49.3 % të ngarkesës mësimore totale për realizimin e programeve të studimit. Në këtë kuadër, <b>GVJ sheh si të nevojshme që të punohet për të rritur numrin e stafit akademik të brendshëm si dhe të punohet për të siguruar qëndrueshmëri të stafit akademik në vazhdimësi.</b></p>	

#### 4. **Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

##### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

KU IKT ka një vend-ndodhje të përhershme; ndodhet në Zayed Center, në Rr. Andon Zako Çajupi, Nr. 6, Tiranë që prej vitit 2011. Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit prej pothuajse 8 vitesh. Kjo sigurohet nëpërmjet kontratës që IKT ka nënshkruar me pronarët e godinës ku ndodhen këto ambiente [dok. Kontratat e Qerases] [dok. Planimetritë] [dok. Raporti i verifikimit të Infrastrukturas së KU IKT]. Për zhvillimin e procesit mësimor në të gjitha programet e studimit të KU IKT janë në dispozicion 6 salla mësimi dhe 6 laboratorë, prej të cilëve 4 laboratorë kompjuterike, 1 laborator Fizike dhe 1 laborator Kimie. Ambientet janë të përshtashme për leksione, seminare dhe laboratorë. KU IKT menaxhon në mënyrë efektive infrastrukturën duke ofruar mësimin për ciklin e parë të studimeve nga e hëna në të premte 09:00-18:00, ndërsa për ciklin e dytë mësimi ofrohet ditëve të javës nga ora 17:00-21:00 dhe të shtunën 9:00-15:00. Biblioteka është e pajisur me një fond të konsiderueshëm librash, ka të gjithë aksesoret dhe lehtësirat për një studim dhe marrje informacioni. [dok. Dokumentacioni mbi Bibliotekën e KU IKT]. Librat elektronikë që ekzistojnë në bibliotekën virtuale të IKT, janë nga bashkëpunimi me McGraw-Hill Education. KU IKT ka 4 laboratorë informatike për qëllime mësimore. Përkatësisht me 21 kompjutera + 1 video projector; 21 kompjutera + 1 video projector; 29 kompjutera + 1 video projector; 29 kompjutera + 1 video projector. Studentet kanë akses në laboratorë në çdo moment gjatë gjithë javës (e hënë – shtunë) nga ora 9:00 deri në 21:00. Ambientet e KU IKT janë të mbuluar me internet. Në katin -1 ku është e vendosur palestra, e cila shfrytëzohet nga studentët edhe nga stafi. GVJ konstaton se mjediset e vëna në dispozicion të programit të studimit janë të mjaftueshme për zhvillimin normal të aktivitetit mësimor.

##### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

###### **Mjediset për Programin e studimit**

Të dhënat për mjediset janë paraqitur në Tabelat Nr 7,8 në Ankes

###### **Mjediset për stafin:**


Të dhënat janë paraqitur në Tabelen Nr 9. në Aneks

###### **Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

N/A

##### **Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
--------------------	-----------------------------



**Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.**

**Kriteri 1** Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;

**Kriteri 2** Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;

**Kriteri 3** Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;

**Kriteri 4** Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.

KU IKT ka një vendndodhje të përhershme; ndodhet në Zayed Center, në Rr. Andon Zako Çajupi, Nr. 6, Tiranë, që prej vitit 2011.

Të gjitha programet zhvillohen në këtë godinë, por KU IKT ka bere një menaxhim efikas, te ambienteve dhe kohes ne dispozicion te programeve te studimit.

Ambjentet kane të gjitha hapësirat e nevojshme për realizimin e praktikave në laboratore, realizimin e mësimdhënies, zyra për administratën, arkivat, bar, mensë dhe zyra për personelin akademik.

KU IKT ofron mësimin për ciklin e parë të studimeve nga e hëna në të premte 09:00-18:00, ndërsa për ciklin e dytë mësimi ofrohet ditëve të javës nga ora 17:00-21:00 dhe të shtunën 9:00-15:00. GVJ konstaton se me rritjen e numrit të studentëve do ta bënte të vështirë menaxhimin efikas të ambienteve edhe pse gjatë gjithë ditës, dhe si rrjedhojë do të kërkojë hapësira të reja.

N/A

**Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.**

**Kriteri 1** Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;

**Kriteri 2** Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;

**Kriteri 3** Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;

**Kriteri 4** Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;

**Kriteri 5** Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.

Për realizimin e programit “Master i shkencave” në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni” me tre profile, në godinën e KU IKT është vënë në dispozicion biblioteka e cila ka kapacitetin e mjaftueshëm për të studiuar studentët. Biblioteka është e pajisur me një fond librash të konsiderueshme në gjuhën angleze, por edhe në gjuhë të tjera. Biblioteka ka dhe hapësirë virtuale, ku librat elektronikë janë nga bashkëpunimi me McGraw-Hill Education. Në bibliotekë kishte botime periodike dhe revista shkencore.

Departamenti paraqet kërkesat e tij për libra që i nënshtrohet një procedure blerje.

Oraret e Biblotekës, janë përshtatur me nevojat e studentëve.

**Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.**

**Kriteri 1** Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

**Kriteri 2** Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

**Kriteri 3** Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;

**Kriteri 4** Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.

KU IKT ka ambiente të mjaftueshme të laboratorëve, klasave, zyrave, studiove dhe mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit për realizimin e programit të studimit, falë mënyrës së menaxhimit të ambienteve. KU IKT disponon 6 laboratorë , 4 laboratorë me kompjutera, një laborator Fizike/Sistemet e Qarqeve dhe një laborator kimie. Alternimi i orarit sipas ciklit të studimeve, por edhe programeve e rrit mundësinë e shfrytëzimit të klasave, laboratorëve, zyrave dhe mjediseve të tjera. Mjediset për leksione dhe laboratore janë të përshtatshme për mësimdhënie, dhe plotësojnë kërkesat e programit. Laboratorët janë si më poshtë:

LAB 1: Përmban 21 kompjutera + 1 video projektor  
 LAB 2: Përmban 21 kompjutera + 1 video projektor,  
 LAB 3: Përmban 29 kompjutera + 1 video projektor.  
 LAB 4: Përmban 29 kompjutera + 1 video projektor,  
 Studentët kanë akses në laboratorë gjatë gjithë javës (e hënë – shtunë) nga ora 9:00 deri në 21:00.  
 Ambientet janë të mbuluar internet.

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

GVJ konstatoi se të gjitha programet e studimit zhvillohen në një godinë. KU IKT ka bërë një menaxhim efikas të ambienteve dhe të kohës. Zyrat e administratës janë vendosur në katin e parë ndërsa mësimdhënia dhe zyrat e personelit akademik janë të vendosura në kate të tjera. Për ciklin e parë të studimeve mësimdhënia ofrohet nga e hëna në të premte 09:00-18:00, ndërsa për ciklin e dytë mësimi ofrohet ditëve të javës nga ora 17:00-21:00 dhe të shtunën 9:00-15:00. KU IKT ka vënë në shërbim të studentëve një bibliotekën më literaturë në gjuhë të huaj, kryesisht anglisht, të dedikuar për programet e studimit. KU IKT disponon 6 laboratorë që janë të kompletuar për të mbështetur zhvillimin e mësimin. Studentët kanë akses në laborator gjatë gjithë orarit mësimor. GVJ konstaton se me rritjen e numrit të studentëve do ta bënte të vështirë menaxhimin efikas të ambienteve edhe pse gjatë gjithë ditës, dhe si rrjedhojë do të kërkojë hapësira të reja.

## **5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare**

### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Bazuar në RVB dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion , KU IKT është institucion jo publik dhe operon si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (shpk). Institucioni financohet nga:

1. Tarifat e studimit që paguhen nga ana e studenteve;
2. Financim nga ana e Ortakut, gjë për të cilën ka edhe një letër angazhimi;
3. Donacione të ndryshme që merren nga ana e IKT.

KU IKT çdo vit kryen Audit Financiar nga ku kontrollohen të gjitha llogaritë kontabël. Kontrolli është i përqendruar nëse janë zbatuar “Standardet Kombëtare të Kontabilitetit” dhe legjislacioni në fuqi. Pasqyrat Financiare të KU IKT janë transparente dhe bëhen publike çdo vit në faqen e internetit të QKB-së. KU IKT ofron bursa studimi për kategori të ndryshme studentësh .

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):**

Të dhënat e paraqitur në Tabelën Nr 10 në Aneks.

Për vitin akademik 2017-2018, të ardhurat kanë rezultuar nga:

- Tarifat për dhe gjatë shkollimit në masën 66%
- Sponsorizimet në masën 21%
- Aktivitetet tregtare në masën 3%

Për vitin akademik 2018-2019, të ardhurat kanë rezultuar nga

- Tarifat për dhe gjatë shkollimit në masën 95%
- Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione në masën 3%
- Aktivitetet tregtare në masën 2%

- Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)**

Informacioni që iu vu në dispozicion GVJ është vetem Raporti i Auditit.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Raporti i Auditit

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifata e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Sipas RVB, KU IKT bën një audit të përvitshëm nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar për situatën financiare, e cila bëhet mbi bilancin e çdo viti kalendarik.</p> <p>Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet dhe të ardhurat, duke iu referuar bilancit.</p> <p>Raporti i auditit përmban një pasqyrë të hollësishme referuar bilancit për të ardhurat dhe shpenzimet. “CIT shpk” financohet nga ortaku i vetëm dhe nuk ka përfituar nga grante të jashtme përveç donacioneve.</p>
<b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b>	


<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Raportet financiare vjetore të hartuara nga KU IKT dërgohen në institucionet respektive dhe sipas ligjeve dhe dispozitave në fuqi.</p> <p>Të ardhura administrohen dhe menaxhohen sipas buxhetit të miratuar nga investitori për çdo njësi akademike dhe administrative.</p> <p>Raportet pasqyrojnë me detaje dhe transparencë të ardhurat nga tarifat e studentëve, sipas kontratave të nënshkruara nga palët dhe faturave tatimore për shërbimin e kryer dhe vitet e kërkuara.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p>	
<p>KU IKT është institucion jo publik dhe operon si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (shpk). Institucioni financohet kryesisht nga tarifat e studimit që paguhen nga ana e studenteve; financim nga ana e ortakut, donacione të ndryshme. KU IKT kryen çdo vit auditim financiar të jashtëm. Financimi dhe të ardhurat për Departamentin e Inxhinierise Softuerike, janë pjesë e informacionit dhe të dhënave të KU IKT. KU IKT nuk ka përfitime nga grande të huaja, në këtë drejtim GJV mendon se duhet më shumë përpjekje në fushën e aplikimit për grante si dhe projekte me të ardhura në bashkëpunim më institucione të tjera të arsimit të lart në vend apo jashtë Shqipërie.</p>	

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

### Pjesa përshkimore

**Terma reference:** institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Bazuar në të dhënat e RVB, Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë e ka nisur punën që në vitin akademik 2012-2013, me Vendim të Senatit Akademik Nr. 16, datë 22. 05. 2013. Referuar Statutit të KU IKT, NJSBC është struktura e brendshme e përhershme e cila është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. NJSBC është organ kolegjal, që përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 2 (dy) janë përfaqësues të personelit akademik të njësive kryesore (një përcilën njësi); 1 (një) personel i administratës; 1 (një) përfaqësues i Këshillit Studentor; dhe 1 (një) ekspert që drejton njësinë. Anëtarët e Njësisë miratohen nga Senati Akademik me propozim të Rektorit, me mandat 4 vjeçar. Kryetari i njësisë, propozohet nga rektori dhe miratohet në Senatin Akademik. Një prej dokumenteve më të rëndësishme të NJSBC është Manuali i Sigurimit të Cilësisë [dok. Manuali i Sigurimit të Cilësisë]. Manuali miratohet çdo vit nga Senati Akademik. NJSBC është angazhuar në proceset e sigurimit të cilësisë në institucion si dhe në proceset e akreditimit institucional apo të programeve të studimit. Kompetencat e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë përcaktuar në




rregullore [dok. Libri i Rregulloreve Institucionale]. NJSBC ka organizuar pothuajse çdo semestër pyetësorë. Pyetësorët kanë qenë anonim dhe online.

Në total janë 14 pyetësor dhe 3 anketime (gjithsej 17) të realizuar nga NJSBC:

4 pyetësorë/anketime kanë qenë institucional të organizuar prej IKT ose institucioneve partnere;

9 pyetësorë janë organizuar me fokus përmbajtjen dhe zbatimin e programit të lëndës si dhe cilësinë e mësimdhënies;

1 anketim ka qenë mbi preferencat e nxënësve të gjimnazeve për programet e ofruara nga KU IKT.

Të dhëna për NJSBC janë paraqitur në Tabelat Nr 11,12 në Aneks.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

**Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:**

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë zhvillon anketime me studentët në fund të ëdo semestri. Me studentët të cilët janë në vit të dytë të Masterit që janë edhe brezi i parë i të diplomuarve janë zhvilluar 3 anketa.

Rezultatet e pyetësorëve janë përpunuar nga NJSBC dhe rezultatet e fituara janë vënë në dispozicion të drejtuesve të institucionit, si edhe në mënyrë të personalizuar për secilin pedagog.

**Kontrolli i brendshëm i cilësisë**

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka në përbërje ekspert, staf akademik si dhe studentë. Pyetësorët janë organizuar në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha ciklet, për të gjitha lëndët dhe pedagogët. Raport i detajuar mbi rezultatet e pyetësorëve i dërgohet drejtuesve të institucionit Dekanit dhe Rektorit, të cilët ndjekin dhe analizojnë me kujdes rezultatet e përfituara prej pyetësorëve.

Anketimi është realizuar me studentët aktual që vazhdojnë studimet si dhe me ata ALUMNI për të parë nivelin e punësimit të tyre. Rrjeti Alumni është aktiv por studentët e këtij programi ende nuk janë diplomuar.

**Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti**

Departamenti ka përgjegjësi në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë. Në cdo fillim viti akademik vlerësohet përbërja e programit të studimit nga stafi akademik i departamentit dhe fakultetit përkatës. Nëse sygjerohen ndryshime ato duhet të aprovohen nga Senati Akademik. E njëjta procedurë ndiqet nëse do të sygjerohej mbyllje apo hapje e një programi të ri. Aktiviteti i monitorimit organizohet nga NJSBC, për secilin nga proceset akademike që kontrollohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë senatit, rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve.

**Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre**

Një pjesë e vlerësimit të pedagogëve, realizohet nëpërmjet procesit të vetvlerësimit. Të gjitha raportet e vetvlerësimit bashkë me të dhënat e pyetësorëve ndërtojnë panoramën e situatës brenda institucionit mbi procesin e mësimdhënies, funksionimit të njësive bazë, kërkimit shkencor si dhe kontributit për çështje administrative nga ana e stafit akademik.





**Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike**

Vetvlerësimet realizohen çdo vit nga stafi akademik. Vetvlerësimi përfshin elementë nga mësimdhënia dhe kërkimi shkencor në mënyrë që të vlerësohet në fund performanca e secilit pedagog. Drejtuesit e institucionit bëjnë vlerësimin e performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të viti akademik.

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**


*Rezultatet e pyetësorëve të drejtuar studentëve.*

*Informacion mbi Alumni, takime të Alumni.*

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <p>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</p> <p>b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</p> <p>c. Pyetje konceptuale;</p> <p>d. Intervista;</p> <p>e. Etj.</p> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <p>a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</p> <p>b. Dëgjime në auditor;</p> <p>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</p> <p>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për</p>	<p>KU IKT ka institucionalizuar praktikën e sigurimit të cilësisë së brendshme duke ngritur NJSBC, e cila përdor metodologji vlerësimi për cilesine e mësimdhënies.</p> <p>Aktiviteti i monitorimit organizohet nga NJSBC, për secilin nga proceset akademike që kontrollohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë senatit, rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve.</p> <p>Metodologjia e vlerësimit mbështetet mbi vetdeklarimin. Ndërsa instrumentët për ta arritur këtë gjë kanë qenë pyetësorët në rastin e studentëve; dhe në rastin e stafit akademik e administrativ, pyetësorët dhe vetvlerësimin.</p> <p>Rezultatet e marra nga pyetësorët, të përmbledhura e të përpunuara, bëhen publike. Marrja e informacionit nga studentet, behet nepermjet pyetësorëve dhe takimet me studentët. Ndërsa për stafin akademik, përdoret raportet për ecurinë e fakultetit nga dekani dhe përgjegjësi departamentit për departamentin si dhe vet-raportimi i stafit akademik në fund të vitit, mbi aktivitetin akademik, përmbushja e objektivave vjetor institucional e atyre personal si dhe mbi detyrat administrative që ata kryejnë.</p> <p>Analiza e këtyre të dhënave reflektohet në raportet vjetore që njësitë kryesore dorëzojnë pranë rektoratit.</p> <p>Pyetësorët janë organizuar në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha ciklet, për të gjitha lëndët dhe pedagogët.</p>

<p>module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	<p>Pyetësorët janë përqëndruar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerësimin e stafit nga studentët</li> <li>- Vlerësimin e studentëve për programet dhe lëndët</li> <li>- Vlerësimin e studentëve për literaturën e përdorur</li> <li>- Vlerësimin nga studentët për shërbimet e ofruara në KU IKT.</li> </ul>
<p><b>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>KU IKT, përgatit dhe shpërndan një raport për përdorim të brendshëm vlerësimet periodike mbi cilësinë, nuk ka ndonjë botim të publikuar.</p> <p>KU IKT, organizon një pyetësor të brendshëm mbi cilësinë e programeve, të personelit akademik, dhe cilësinë e mësimdhënies, , por nuk ka te dhena publike.</p>
<p><b>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>GVJ konstaton se hartohen raporte vjetore në lidhje me ecurinë e programeve të studimit në KU IKT. NJSBC përdor metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse për ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies, cilësisë së literaturës së përdorur. Aktiviteti i monitorimit organizohet nga NJSBC, për secilin nga proceset akademike që kontrollohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë senatit, rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve</p> <p>KU IKT ka hartuar dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë bërë publike.[dok.Strategjia Zhvillimit të KU IKT]</p>
<p><b>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</b></p>	




<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>KU IKT është i akredituar në nivel institucional me agjencinë britanike QAA dhe ASCAL në vitin 2017, për 5 vjet [ dok. Certifikata e Akreditimit].</p> <p>KU IKT ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ka përgatitur një sërë instrumentesh të cilat i përdor në funksion të sigurimit të cilësisë.</p> <p>KU IKT ka përgatitur manualin e cilesise[ dok. Manuali i Sigurimit te Cilesise QAU Handbook]</p> <p>NJSBC kryen monitorimin e herë pas hershme të programeve të studimit.</p> <p>KU IKT ka organizuar trajnime për informimin dhe ndërgjegjësimin e stafit dhe të studentëve për sigurimin e cilësisë dhe rolin e tyre në këtë proces.</p> <p>KU IKT nepermjet NJSBC zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. NJSBC prej disa vitesh drejtohet dhe ka në përbërje një staf të konsoliduar. Me zgjerimin e institucionit si dhe rritjen e numrit të studentëve, KU IKT mendon te zgjeroje edhe NJSBC ne nivel Fakulteti dhe Departamenti [Takimi me Drejuesit e KU IKT dhe programit te studimit]</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p>KU IKT ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila ka përgatitur një sërë instrumentesh të cilat i përdor në funksion të sigurimit të cilësisë. Sigurimit të cilësisë në KU IKT ndiqet nga strukturat drejtuese dhe monitorohet në mënyrë te vazhdueshme nga NJSBC. NJSBC prej disa vitesh ka një staf të konsoliduar. Vlerësimi për procesin mësimor bëhet dy herë në vit online. Vlerësimet pasqyrohen në raporte të cilat bëjnë publike rezultatet e përpunuara. Me zgjerimin e institucionit si dhe rritjen e numrit të studentëve, KU IKT mendon të zgjerojë edhe NJSBC në nivel Fakulteti dhe Departamenti.</p>	

## POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

### 7. Programi i studimit, organizimi i tij

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Bazuar në RVB dhe në dokumentacionin e programit të studimi "Master i shkencave" në "Inxhinieri kompjuterike dhe teknologji informacioni", me profile: "Inxhinieri kompjuterike dhe BIG Data"; "Rrjetet kompjuterike dhe Siguria Kibernetike"; "Multimedia-Dizajn" gjejmë të përcaktuar misionin dhe

objektivat e ndara sipas profileve [RVB fq 57,58; dok "Rregullore e programit të studimit Msc. Inxh.Kompjuterike dhe IT shqip-anglisht"].

Referuar RVB [fq 57, 58,59], objektivat mund të përmblihen si më poshtë:

Profili "Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike" ofrohet për studentët e diplomuar që dëshirojnë të punësohen në kompani që kërkojnë njohuri dhe aftësi të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit kompjuterik; të sistemeve operative të sigurta, të aplikacioneve të sigurta, apo të vazhdojnë doktoraturën në fushën e sigurisë së informacionit. Gjithashtu, të kuptojnë se si zhvillohet një politikë e sigurisë dhe si politikat drejtojnë vendimet teknologjike bazuar në njohuritë teorike dhe punës laboratorike në fushën e sigurisë së informacionit.

Profili "Inxhinieri Kompjuterike dhe Big Data" është i përcaktuar për studentët me baza të forta në matematikë, shkencat kompjuterike, dhe statistik të aplikuar. Programi ka si objektiv të sigurojë teorinë dhe metodat themelore të kërkimit të të dhënave, duke plotësuar nevojën e tregut të punës me profesionistë në fushën e të dhënave.

Profili "Inxhinieri Kompjuterike dhe Multimedia Dizajn" ofron njohuri kompjuterike, njohuri në fushën e komunikimit interaktiv, përdorimin e teknikave për vizualizimin e të dhënave dhe krijimin e ndërfaqeve të sistemeve kompjuterike. Programi ka si objektiv të formojë inxhinierë me aftësi për projektim dhe ndërtim të ndërfaqeve softuere, për të gjitha platformat celulare, tabletë, desktopët, TV dhe pajisjet të tjera.

Studentët që përfundojnë programin në profilin "Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike" mund të punësohen në departamentet e sigurisë së informacionit, të teknologjisë së sigurisë, në menaxhim të informacioneve kritike, në zyra studimore lidhur me sigurinë kibernetike.

Studentët që përfundojnë programin në profilin "Inxhinieri Kompjuterike dhe Big Data" mund të punësohen në institucionet financiare, si menaxher informacioni në kompani, si përgjegjës për analizat statistikore të informacionit në bazat e të dhënave të mëdha, si dhe zhvillimin e modeleve për të mbështetur proceset vendimmarrëse në kompani, si analist i të dhënave të mëdha.

Studentët që përfundojnë programin në profilin "Inxhinieri Kompjuterike dhe Multimedia Dizajn" mund të punësohen si konsulentë multimedia, designers, animatorë tek prodhuesit audio dhe video, në sistemet kompjuterike, në ndustrinë e projektimit, në industrinë botuese software, dhe industria e reklamave.

Koordinatorët dhe anëtarët e Këshillit Shkencor të programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri kompjuterike dhe teknologji informacioni", me profile: "Inxhinieri kompjuterike dhe BIG Data"; "Rrjetet kompjuterike dhe Siguria Kibernetike"; "Multimedia-Dizajn" janë përcaktuar me vendim

senati [dok. Vendim Senati Akademik Nr 19, date 29.11.2018], si koordinator programi janë vendosur 2 (dy) nga anëtarët e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie, të cilët kanë titullin Prof dhe me grade shkencore PhD. Ndërsa këshilli shkencor përbëhet prej 3 Profesorë , antarë të stafit akademik.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

#### **Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi**

Programi “Master i shkencave” në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni”, me profile, është licensuar në vitin 2016. Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë Softuerike ne Fakultetin e Inxhinierisë dhe ka filluar aktivitetin në vitin akademik 2017-2018. Programi është në vitin e dytë të aktivitetit të tij dhe akoma nuk ka studentë të diplomuar. Qëllimi i objektivat janë paraqitur në paragrafin më sipër.

#### **Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)**

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
- 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit
- 1 orë mësimore = 60’ ku përfshihet 10’ pushim

Programi zhvillohet në një periudhë prej dy vitesh dhe organizohet ne 4 semestra. Senati Akademik në fillim të çdo viti miraton Planin Kalendarik sipas të cilit bëhet organizimi i procesit mësimor [dok” Planin Kalendarik Vjetor i KU “IKT” 2018-2019”]

Emërtimi i Diplomës për programin e studimit:

“Master i shkencave” në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni”

Profili: “Inxhinieri Kompjuterike dhe Big Data”

Profili: “Rrjetet Kompjuterike dhe Siguria Kibernetike”

Profili: “Multimedia-Dizajn”

#### **Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë [Tabela 14 ne Aneks]**

Plani Mësimor për programin “Master i shkencave” në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni”, për të tri profilet paraqitet në Tabela 14. Ndarja e 25 orëve të një krediti është bërë sipas udhëzimeve të MASR , Udhëzimi Nr. 15 datë 04.04.2008. Në vitin e parë, një kredit leksion është e përcaktuar në 10 orë në auditor dhe 15 orë jashtë tij , ndërsa për ushtrimet janë 12 orë në

auditor dhe 13 orë jashtë tij. Ndërsa në vitin e dytë ose me saktë në semestrin e tretë, kemi një ndarje tjetër, një kredit leksion është e përcaktuar në 12 orë në auditor dhe 13 orë jashtë tij, ndërsa për ushtrimet janë 17 orë në auditor dhe 8 orë jashtë tij, ndarja qëndron gjithmonë brenda intervaleve të përcaktuara në udhëzim. Ngarkesa javore është 20 orë në javë [ Tabela 14]. Mësimdhënia është në gjuhën Angleze. Format e mësimdhënies përfshijnë ato të leksioneve, seminareve, orëve në laborator, projekteve dhe ushtrimeve. Semestri I, për të tre profilet është i njëjtë, pra 30 kredite janë të njëjta. Praktika mësimore dhe tema e diplomës, kanë përkatësisht 12 dhe 24 kredite, në të tre profilet.

Në rastin e praktikës mësimore janë llogaritur të gjitha orët, 300 orë (12 kredite x 25 orë) në auditor dhe për diplomën të gjitha orët 600 orë jashtë auditorit. GVJ mendon se në rastin e praktikës janë të nevojshme përcaktimi orëve jashtë auditorit për përgatitjen që duhet të bëjë studenti për provimin e praktikës, ndërsa në rastin e diplomës përcaktimi i orëve në auditor janë të domosdoshme për të saktësuar orët në konsultim me udhëheqësin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit është e përcaktuar qartë që takimet me udhëheqësin e diplomës bëhet sipas një kalendari. [dok. Rregullore e programit të studimit Msc. Inxh.Kompjuterike dhe IT shqip-anglisht]

Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-F) për të tre profilet është i njëjtë, 12 kredite ose 10% janë në veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (A); 48 kredite ose 40% janë në veprimtari në disiplina të formimit karakterizues (B); 12 kredite ose 10% janë në veprimtari në disiplina të ngjashme dhe/ose integruese (C); 6 kredite ose 5% janë në veprimtari në disiplina me zgjedhje (D); 18 kredite ose 15% janë në njohuri të tjera formuese si plotësime në gjuhët e huaja, informatikë, stazh, apo praktika (E) dhe 24 kredite ose 20% janë në Tezën e Diplomës (F). **GVJ konstaton se lënda “Database Design and Administration” e përcaktuar si lëndë në kategoria E, do të ishte më me vend të përcaktohej si lëndë e formimit karakterizues B.**

Gjatë vizitës u konfirmua nga drejtuesit e institucionit, se KU IKT ishte duke punuar për riorganizimin e programit të studimit sipas VKM 41, datë 24.01.2018 ““Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë””.


**Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:**

- Për leksionet 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret 12 orë në auditor dhe 13 orë punë e pavarur e studentit
- Për Laboratoret 18 orë në auditor dhe 7 orë punë e pavarur e studentit
- Për projekt kursi 2 orë në auditor dhe 23 orë punë e pavarur e studentit

Ndarja 25 orë e një krediti në orë në auditor dhe jashtë auditorit është bërë brenda intervalit të përcaktuar në udhëzimet e Ministrisë së Arsimit.

**Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara.**

Nuk ka ndryshime në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara.



**Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Tabela 20 ne Aneks)**

Nga të dhënat vihet re që stafi akademik është i kualifikuar , në përputhje me programin e studimit master i Shkencave. Bazuar në të dhenat e Tabelës 21, konstatohet se janë angazhuar gjithsej 13 staf akademik, nga te cilet 8 PAE dhe 5 PAK.

**Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë**

Bazuar në dokumentacionin e vëne në dispozicion [dok. Programet (silabuset) e lendeve MSc in Computer Engineering and Information Technology] si dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se programet e lëndëve janë hartuar në përputhje me udhëzimet e MASR, dhe përmbajnë elementet si me poshtë:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

**Analizë e cilësisë së syllabuseve**


Referuar programeve të lëndëve, edhe pse paraqiten shumë të dhëna vihet re se nuk aplikohen të dhëna në lidhje me njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetësimin e lëndës.


**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Programet e lëndëve që mungonin në sistemin e ASCAL

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
--------------------	-----------------------------





**Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.**

**Kriteri 1** Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);  
**Kriteri 2** Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;

Programi i studimit "Master i shkencave" në "Inxhinieri kompjuterike dhe teknologji informacioni", me profile: "Inxhinieri kompjuterike dhe BIG Data"; "Rrjetet kompjuterike dhe Siguria Kibernetike"; "Multimedia-Dizajn" kalon për herë të parë procedurat e vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit.

Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student që ndjek këtë program studimi me kohë të plotë është 60 kredite. Për të dy vitet e studimit, studenti duhet të grumbullojë 120 kredite

**Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.**

**Kriteri 2** Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave", "Master i arteve të bukura" apo "Master Profesional" i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare "Bachelor" me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;

**Kriteri 3** Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukura" dhe "Master Profesional" synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;

**Kriteri 4** Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;

**Kriteri 5** Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;

**Kriteri 6** Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukura" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;

**Kriteri 7** Programet e studimeve "Master Profesional" kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Programi i studimit "Master i shkencave" në "Inxhinieri kompjuterike dhe teknologji informacioni", me profile: "Inxhinieri kompjuterike dhe BIG Data"; "Rrjetet kompjuterike dhe Siguria Kibernetike"; "Multimedia-Dizajn" synon të krijojë një figurë profesionale me njohuri të thelluara teorike e praktike në fushat përkatëse, të aftë për t'u bërë pjesë e tregut të punës. Programi synon të zgjerojnë njohuritë bazë të marra nga të diplomuarit në programin Bachelor si dhe krijon baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoraturë, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor. [dok "Rregullore e programit të studimit Msc. Inxh.Kompjuterike dhe IT shqip-anglisht"].

Departamenti nuk kishte bërë asnjë ndryshim të planit mësimor që nga hartimi i tij. Programi është në vitin e dytë, vitin akademik 2018-2019, do të ketë të diplomuarit e parë dhe do të kalojë akreditimin më të njëjtin plan mësimor që ka filluar.

**Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshatje me nivelin e studimeve.**

**Kriteri 1** Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve

Përmbajtja e programeve të studimit dhe organizimi i tij janë në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin




<p>të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arrijtjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>ofrohen. Përvorimet e ndërmjetme përfshijnë 30 % të vlerësimit të lëndës, [dok. Programet e lendeve MSc in Computer Engineering and Information Technology][ Takimi me stafin akademik]. Kontrolli i vazhdueshëm i studentëve, projektet e kurseve , prezantimi i projekteve si dhe prezenca në klasë, janë tregues të ecurisë dhe arrijtjeve të studentëve për ciklin e dytë të studimeve. Elementet kryesore të kontrollit të vazhdueshëm janë: provimet e ndryshme, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit në seminare apo punë laboratorike, provimet e ndërmjetme, vlerësimet mbi bazën e përgjigjeve të sakta [dok. Rregullorja “Vlerësimi i Studentit”]</p>
<p><b>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve mbështeten në përvojën disaveçare dhe praktikatat e mira të vendeve europiane;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomatat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi i studimit “Master i shkencave” në "Inxhinieri kompjuterike dhe teknologji informacioni", me profile: "Inxhinieri kompjuterike dhe BIG Data"; "Rrjetet kompjuterike dhe Siguria Kibernetike"; "Multimedia-Dizajn" është hartuar duke u mbështetur në përvojat jashtë vendit, si në Amerikën e Veriut dhe Europë [ Takimi me Rektorin, Dekanin dhe Shefin e Departamentit]. Nuk ka studim të mirëfillte tregu, specifikisht për këtë program studimi, por hartimi i tij është mbështetur në strategjinë e zhvillimit të Institucionit [Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024]</p> <p>Gjithashtu ky program është hartuar në përputhje me deklaratën e Bolonjës dhe udhëzimeve të MASR.</p>
<p><b>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arrijtjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Në planin mësimor të programit të studimit është përfshirë praktika mesimore profesionale, 12 kredite , e cila kryhet gjatë semestrit të fundit, dhe zgjat gjithë semestrin. [dok. Manuali i Praktikes Mesimore Fakulteti i Inxhinierise ]</p> <p>GVJ konstatoi se personeli akademik angazhohet në punën kërkimore dhe në projekte, në të cilat janë të përfshirë edhe studentët. Stafit akademik kanë marrë pjesë në konferenca shkencore si dhe kanë botuar artikuj në revista. [ Takimi me stafin akademik] [dok. CV Fakulteti i Inxhinierise]. Programi i studimit është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të IKT [dok. Strategjia e Zhvillimit të KU IKT 2024]</p>
<p><b>Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>N/A</p>
<p><b>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</b></p>	

<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar;</li> <li>kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> <li>numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</li> </ol>	<p>Programi i studimit “Master i shkencave” në “Inxhinieri kompjuterike dhe teknologji informacioni”, me profile: “Inxhinieri kompjuterike dhe BIG Data”; “Rrjetet kompjuterike dhe Siguria Kibernetike”; “Multimedia-Dizajn” është hartuar duke u mbështetur në Planin e Fizibilitetit si dhe në faktin që të gjitha programet master janë vazhdimësi e programeve Bachelor perkates. Është marrë gjithashtu parasysh, përveç kërkesave të studentëve të ciklit të parë, edhe vlerësimi nevojave të tregut. [Takimi me drejtues të programit të studimit].</p> <p>GVJ konstatoi gjatë vizitës se ka një studim tregu i vitit 2016, për këtë program studimi ku jepen te dhena mbi programet bachelor dhe master të ofruara në fushën e Inxhinierisë kompjuterike dhe Teknologjisë së Informacionit në IAL publike dhe private, mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; apo edhe numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet te tjera. Ky dokument paraqitet më tepër si projekti dhe planet financiare të programit të studimit.</p>
<p><b>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi “Master i shkencave” në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni” (me tre profile) ka 120 kredite, nga të cilat 24 kredite janë per tezen. Kohëzgjatja është 2 vite akademike. Programi nuk bien ndesh me interesat kombëtare, perkundrazi ai kontribuon ne ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>
<p><b>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezen që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Programi “Master i shkencave” në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni” (me tre profile) ka 120 kredite, nga të cilat 24 kredite janë per tezen dhe 12 për praktikën, 36 ECTS në total. Kohëzgjatja është 2 vite akademike.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6</p>	

vite për studimet në fushën e mjekësisë).	
<b>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Plani Mësimor publikohet në faqen Web, në të cilën shfaqen lëndët, semestrat, shpërndarja e krediteve si dhe lëndët me zgjedhje. Referuar [dok. Guida e Studentit] studenti ka informacionin e duhur në programin që ata ndjekin. Guidat janë të publikuara online. Në fillim të vitit akademik studentët informohen nga stafi akademik mbi ndjekjen e programit të lëndës, detyrimet akademike, mënyrën e vlerësimit.</p>
<b>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Bazuar në planin mësimor të programit “Master i shkencave” në “Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji Informacioni”, me profile, plani i diplomimit është planifikuar në semestrin e dytë, pas përfundimit të praktikës. Programi i studimit është i publikuar në faqen e internetit të IKT. Studentet janë të informuar dhe orientohen mbi temën e diplomës si dhe drejt fushave dhe temave që ata mund të zgjedhin [Takimi me studentet], [dok. Manuali i Diplomës]. Datat e mbrojtjes së diplomës përcaktohen prej Departamentit dhe Fakultetit sipas “Planit Kalendarik Vjetor të KU IKT” të miratuar për vitin përkatës.</p>
<b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b>	
<p>GVJ konstatoi se përmbajtja e programit të studimit “Master i shkencave” në “Inxhinieri kompjuterike dhe teknologji informacioni”, me tre profile, dhe organizimi i tij janë në përputhje me nivelin e studimeve në të ciklit të dytë Master i Shkencave. Studentët kanë marrë të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit dhe lëndët e modulet e tij. Programi i studimit ka dokumentacionin e nevojshëm për informim të studentëve si planin mësimor dhe programet e lëndëve. Të dhënat për programin e studimit, planin mësimor gjenden edhe në faqen e internetit të institucionit, por jo programet e lëndëve. Konstatohet se programi mësimor është hartuar konform udhëzimeve të ministrisë për shpërndarjen e krediteve, orëve mësimore në auditor dhe jashtë auditori. <b>Tipologjia e lëndëve në % sasiore është brenda kufijve të përcaktuar në udhëzim, por GVJ sugjeron që gjatë zbatimit të udhëzimit të ri të bëhet përcaktimi i më i saktë i tipologjisë së lëndëve.</b> Programi është në gjuhën angleze, studentët kanë mundësi të shfrytëzojnë literaturën bazë dhe të rekomanduar në këtë gjuhë. GVJ konstatoi se programi i studimit ka një plan diplomimi dhe se një pjesë e studenteve kishin përcaktuar temat e diplomave.</p>	

## 8. Mësimdhënia




## Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.


Referuar RVB dhe vizitës në Institucion ,GVJ konstatoi se procesi mësimor është i organizuar në vite akademike edhe semestra. Viti akademik zgjat 30 javë mësimore , një semester ka 15 javë mësimore. Koha e fillimit, mbarimit, sesionet e provimeve, pushimet e festave zyrtare përcaktohen në kalendarin akademik të miratuar nga Senati [dok. Plani Kalendarik vjetor (2018-2019) ]. Format e mësimdhënies: Format kryesore të mësimdhënies janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyrat ose projekte kursi, praktikat profesionale. Numri total i veprimtarive formuese për secilin profil është 16, ku 14 janë lëndë dhe module, 1 praktikë dhe teza e diplomës. Lëndët zhvillohen mbasdite sipas orarit mësimor të shpallur. Kontrolli i dijes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Kontrolli i njohurive zhvillohet nëpërmjet formave të përcaktuara nga institucioni: provim, prezantim, provim i ndërmjetëm, projekt/detyrë kursi në varësi të lëndëve. Në planin mësimor përfshihen si lëndët e detyrueshme dhe ato me zgjedhje (6 kredite ose 5% të ngarkesës totale). IKT ka përcaktuar një formë të përgjithshme të kontrollit të njohurive [dok. Vlerësimi i Studentit], [dok. Guida e Studentit]. Vlerësimi në përfundim të secilës lëndë përfshin ndjekjen e lëndës dhe pjesëmarrjen aktive 10%, plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit) 40%, testimet gjatë vitit 20% dhe provimi përfundimtar 30% . Referuar programeve të lëndëve [ dok. Programet e lendeve MSc in Computer Engineering and Information Technology] ka një ndryshim prej 20% për çdo zë, sipas lëndes, [Takimi me stafin] me arsyetimin e respektimit të lirisë akademike. GVJ e evidentoi që ka një vlerësim periodik nga ana e studentëve për stafin akademik dhe procesin mësimor [Takimi me stafin akademik],[Takimi me studentet].

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

#### Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

• Leksione	420
• Seminare	48
• Ushtrime	256
• Laboratore	180
• Projekt kursi	20
• Praktikë profesionale	300
• Totali	1224 ore

#### Format e kontrollit të njohurive



Referuar Tabela Nr 16 në Aneks, vlerësimi në përfundim të secilës lëndë përfshin ndjekjen e lëndës dhe pjesëmarrjen aktive 10%, plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit) 40%, testimet gjatë vitit 20% dhe provimi përfundimtar 30%.

**Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj**

Studentët përfshihen në mbledhjet që zhvillon Departamenti dhe ne aktivitete të tjera të organizuara nga KU IKT. GVJ nuk konstatoi pjesëmarrje të studentëve në punime shkencore të stafit akademik si dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore apo mobilitete. Për këtë vit është planifikuar zhvillimi i Konferencës studentore në bashkëpunim me një universitet tjetër privat.

Ora e mësimit në RVB është shënuar 60 minuta, ndërsa nga takimet në institucione u saktësua se është 50 minuta me intervale pushimi 10 minutëshe.

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Nuk ka

## 9. Studentët

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Referuar RVB, kriteret e pranimit të studentëve në ciklin e dytë miratohen çdo vit. Aplikimi i kandidatëve me dokumentacionin përkatës, bëhet gjatë periudhës që përcaktohet në Udhëzimet e MASR të cilat dalin për çdo vit akademik. Kandidatët e interesuar për regjistrim për programet e ciklit të dytë paraqiten pranë sekretarive mësimore për plotësimin e formularit të aplikimit si dhe dorëzimit të dokumentacionit të pranimit. Programi i studimit pranon kandidatët në varësi të kapaciteteve infrastrukurore dhe akademike, përmes miratimit të kuotave të dorëzuara në MASR dhe sipas kriterëve specifike që mund të përcaktohen paraprakisht nga Këshilli i Fakultetit. Numri maksimal i studentëve që mund të regjistrohen dhe mënyrat e përzgjedhjes së tyre, bëhen publike çdo fillim viti akademik para fillimit të regjistrimeve [Takimi me Rektoren, Dekanin dhe Shefin e departamentit]. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se në vitin akademik 2017-2018 janë regjistruar për herë të parë 19 studentë, një prej tyre është çregjistruar. Në vitin akademik 2018-2019 janë regjistruar për herë të parë 22 studentë, dy prej tyre janë çregjistruar. Nga studentët e rregjistruar, 9 studentë ndjekin profilin "Big Data" dhe 13 studentë profilin "Cyber Sycurity". Edhe pse në kriteret e pranimit, është përcaktuar se mesatarja e programit të ciklit të parë preferohet të jetë mbi 7.5, mesatarja e studentëve në hyrje, me disa përjashtime, akoma nuk i kap këto

nivele. Në sekretarinë mësimore GVJ ju vunë në dispozicion dosjet e studentëve si dhe rregjistrat themeltarë. Grupi konstatoi se sekretaria mësimore e disponon dokumentacion konform rregulloreve dhe procedurave. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, u kontrolluan në mënyrë të rastësishme tre dosje studentësh, 2 studentë nga viti i I dhe një nga viti i dytë. Të tre dosjet përmbanin dokumentacionin e plotë, ndërsa nota mesatare e studimeve Bachelor ishte përkatësisht për studentin e parë 5.93, për të dytin 6.06 dhe për të tretin 5.2. GVJ konstatoi se nuk kishte mobilitete studentësh për këtë program studimi. Studentët e vitit të dytë përfundojnë studimet me mbrojtjen e diplomës në vitin akademik 2018 – 2019. GVJ evidentoi se departamenti iu kishte caktuar temën e diplomës dhe udhëheqësit e tyre. GVJ konstatoi gjatë takimit me studentët se ata ishin të punësuar por nuk mundi të nxirrte informacion të saktë nëse ishin të punësuar të gjithë sipas fushës së studimit.

#### **Vlerësimi i Tregues të matshëm:**

**Procedurat e pranimit të studentëve**

Procedurat e pranimit janë të publikuar për të gjithë të interesuarit. Edhe pse preferohet mesatarja mbi 7.5 , ky objektiv është akoma larg. [Tabela 18, në Aneks]

**Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve**

Referuar Tabelës 18 në aneks si dhe vizitës në sekretarinë mësimore, nota mesatare e studentëve në hyrje është 6.38 dhe mesatarja e vitit të parë, viti akademik 2017-2018, është 7.55. Niveli i kalueshmërisë 89.5%.

**Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare**

Të dhënat jane paraqitur në Tabelën 18 në Aneks.

**Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare**

Nuk ka akoma të diplomuar. Viti akademik 2018-2019 është viti i parë i diplomimit.

**Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend**

Në programin e studimit nën akreditim nuk ka raste të mobiliteteve të studentëve.

**Të dhëna për punësimin e studentëve**

Nuk ka të dhëna nga institucioni për punësimin e studentëve në lidhje me profilin e tyre. GVJ konstatoi gjatë takimit me studentët se ata ishin të punësuar por nuk mundi të nxirrte informacion të saktë nëse ishin të punësuar të gjithë sipas fushës së studimit.



**Numri total të diplomuarve**

Nuk ka studentë të diplomuar.

**Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)**

Nuk ka të dhëna sepse nuk ka të diplomuar. Një pjesë e studentëve janë të punësuar.

**Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)**

Nuk ka të dhëna sepse nuk ka të diplomuar.

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Tabelat e plotësuara sipas modelit të ASCAL.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni vlerëson herë pas here politikën e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Studentët që ndjekin programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri kompjuterike dhe teknologji informacioni", me profile: "Inxhinieri kompjuterike dhe BIG Data"; "Rrjetet kompjuterike dhe Siguria Kibernetike"; "Multimedia-Dizajn" zotërojnë së paku diplomën universitare Bachelor dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga KU IKT</p> <p>Certifikata e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare është një nga kriteret e pranimit. Mësimdhënia zhvillohet në gjuhën angleze.</p>
<b>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikën e punësimit.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>KU IKT ju ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës, ndiqet një politikë mbështetëse për studentët, nëpërmjet veprimtarive të orientimit. Studentëve u bëhet e njohur informacioni mbi akreditimin e programit që në kontaktin e parë me institucionin. Cdo vit organizohet dhe Java e Tutoriatit (Këshillimit Akademik).</p>
<p><b>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>KU IKT disponon statistika për numrin e të diplomuarve dhe studentëve që pritet të diplomohen [Takimi në sekretarinë mësimore]</p> <p>KU IKT ka statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërhequr dhe largimin para përfundimit të programit dhe mospërfundimin me sukses të vitit akademik. KU IKT disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi e në vazhdim [Takimi në sekretarinë mësimore]</p>
<p><b>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Eshtë ngritur rrjeti Alumni, por nuk ka një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë. [ Takimi me përfaqësues të Alumni, e punësuar në KU IKT]</p> <p>Aktualisht nuk ka të aktivizuar programe studimi të mëtejshëm për shkak të statusit jo universitet të KU IKT.</p> <p>KU "IKT" ka një sistem të vetin për hedhjen e të dhënave, sidomos ato që kanë të bëjnë me programet, vlerësimet e studentëve, kalueshmërinë etj.</p>
<p><b>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Studentët informohen në detaje për programin e studimit, kohëzgjatjen, organizimin e tij, statusin e akreditimit. Informacionet janë të publikuara edhe online. Informacionet më kryesore u jepen studenteve në fillim të vitit në formën e një broshure [dok. Guida e Studentit] e cila u dërgohet në formë elektronike, si dhe është e disponueshme në hard copy.</p> <p>Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit. Pedagogu</p>



	diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve. [ Takimi me stafin akademik] [Takimi me studentët]
<b>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor; <b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.	KU IKT ju ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor. KU IKT ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale. [Takimi me zyrën e karrierës] Ka marrëveshje bashkëpunimi për zhvillimin e praktikës profesionale.
<b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b>	
Bazuar në dokumentacionet përkatëse që gjenden në sekretarinë mësimore, për këtë program studimi, GVJ konstatoi se ka të dhëna statistikore në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programin e studimit dhe për ecurinë e tyre. KU IKT ka kritere në hyrje për cilësinë e studentëve preferenciale në lidhje me mesataren e studimeve të ciklit të parë. Studentët kanë shërbim të këshillimit të karrierës. Studentët informohen për programin e studimit, kohëzgjatjen, organizimin, statusin e akreditimit . Informacionet janë të publikuara edhe online. Informacionet më kryesore u jepen studentëve në fillim të vitit nëpërmjet broshurës Guida e Studentit.	


## KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

### 10. Kërkimi shkencor

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe në RVB, GVJ konstaton se KU IKT ka një strategji të kërkimit shkencor, ku mbështet politikat e kërkimit shkencor, në rang institucioni [dok. Strategjia e Kerkimit Zhvillimit dhe Krijimitarise (RDC) 2014]. Në Tabelën 17 në Aneks janë paraqitur konferencat e organizuara prej IKT, gjithësej 11 konferenca , periudha 2012-2017. Nuk ka konferenca gjatë dy viteve që programi i studimit është aktiv , për të gjykuar pjesëmarrjen stafit apo studentëve të këtij programi studimi. Në RVB janë paraqitur të dhëna në lidhje me stafin akademik në pjesëmarrjen në borde editoriale ose organizma institucional shkencor. Një pjesë e tyre nuk janë staf akademik i




brendshëm dhe si rrjedhojë akteviteti i tyre shkencor lidhet edhe me atributin e te qenurit staf i brendshëm në institucione të tjera. Kërkimi shkencor i stafit akademik zhvillohet në kuadër të kualifikimeve të tyre. KU IKT nëpërmjet revistës shkencore "CIR Review Journal" i mundëson stafit akademik të botojnë artikujt e tyre shkencorë. Gjatë vizitës GVJ, kërkoi të ketë një listë të publikimeve shkencore të stafit akademik, projektet dhe angazhimi i studentëve, në nivel programi. Nga të dhënat e dërguara [dok.Publikimet shkencore të stafit akademik, angazhimi i studentëve dhe projektet] nga njëra anë tregohet se stafi akademik është i angazhuar në botime shkencore, por nga ana tjetër është vështirë të evidentohet, nëse publikimet janë mbështetur nga KU IKT apo janë paraqitur në aktivitete shkencore të organizuara nga institucioni, po ashtu nuk gjenden të dhëna të përfshirjes së studentëve të këtij programi studimi.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

**Të dhëna për kërkimin shkencor**

Të dhënat për kërkimin shkencor janë paraqitur në nivel Institucioni , ndaj nuk mund të veçohen ato që kanë lidhje direkte me programin e studimit që është nën akreditim.

**Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL**

*(Përshkruar më sipër)*

**Numri i projekteve kërkimore të fituara**

*(Përshkruar më sipër)*

**Numri i projekteve të zbatuara**

*(Përshkruar më sipër)*

**Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL**

*(Përshkruar më sipër)*

**Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL**


*(Përshkruar më sipër)*

**Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor**

*(Përshkruar më sipër)*

**Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor**

*(Përshkruar më sipër)*



Numri i Çmimeve Kombëtare

N/A

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disipinën përkatëse; <b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	Stafi akademik angazhohet rregullisht në veprimtaritë të kërkimit shkencor, të cilat janë në përpuethshmëri me disipinat ku angazhohet. Veprimtaritë janë si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar.
<b>Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj; <b>Kriteri 2</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.	Programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Kompjuterike dhe Teknologji informacioni", me tre profile, zhvillohet në gjuhën angleze.
<b>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor; <b>Kriteri 2</b> Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.	KU IKT organizon konferenca kombëtare dhe mbështet pjesëmarrjen në konferenca të ndryshme shkencore të stafit akademik dhe atij mësimor-shkencor. KU IKT ofron mbështetje shkencore për kualifikimin e mëtejshëm të stafit akademik.
<b>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi; <b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi; <b>Kriteri 3</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program	KU IKT disponon të dhëna për publikimet e anëtarëve duke identifikuar vitin, autorin, llojin e publikimit etj.  KU IKT disponon të dhëna për projektet kombëtare e ndërkombëtare në të cilat merr pjesë stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi.

studimi.	
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p>Stafi akademik angazhohet në veprimtaritë të kërkimit shkencor, të cilat janë në përputhje me disiplinat e tyre. KU IKT nëpërmjet revistës shkencore “CIR Review Journal” i mundëson stafit akademik të botojnë artikujt e tyre shkencorë. KU IKT e mbështet në aktivitetin shkencor dhe akademike të stafit akademik. KU IKT organizon një konferenca dhe ka pjesëmarrje në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.</p>	

## 11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Bazuar në dokumentacion e vënë në dispozicion si dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se KU IKT ndjek një politikë të hapur në lidhje me bashkëpunimet dhe partneritetet në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar [dok.Strategjia e Zhvillimit të KU IKT][dok. Marrëveshjet Institucionale të KU “IKT”]. IKT ka nënshkruar marrëveshje me kompani të ndryshme për zhvillimin praktikave profesionale. Midis tyre janë:

- IASTE Albania (International Association for the Exchange of Students for Technical experience)
- Communication Progress LTD, Tiranë
- Universiteti "ILIRIA" (UI), Prishtinë
- Microsoft IT Academy
- The National Food Authority (NFA), Tiranë
- SAS ICT 5, MONTPELLIER
- Plus Communication




- Albtelecom & Eagle Mobile

- Albanian Post

- Local Web

Në Tabelën 24 në Aneks janë paraqitur të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

#### **Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar**

Të dhënat e paraqitura nga RVB, janë në kuadrin e aktivitetit të përgjithshëm të KU IKT, në Tabelë 23 ne Ankes, paraqiten në rang Fakulteti:

Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare	14
Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj (ose orë mësimore)	23
Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit	1
Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt programit të studimit	8 (5 kanë hyrë dhe 3 kanë dalë)
Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor	6 laboratorë
Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime	20


GVJ evidentoi se, që në prill 2017, IKT është pjesë e projekteve CEEPUS në fushën e IT për vitin 2017-2018. Në kuadër të projektit janë kryer mobilitete të studentëve dhe lektorëve, 10 studentë dhe 3 lektorë.

#### **Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:**

Të dhënat e paraqitura nga RVB si dhe të kofirmuara gjatë vizitës në institucion, janë në kuadrin e aktivitetit të përgjithshëm të KU IKT, GVJ e ka të vështirë të evidentojë apo të vecojë të dhënat që lidhen direkt me programin e studimit. GVJ konstaton se nuk mund të përcaktohet qartë masa e përfitimit të bashkëpunimeve për programin Master dhe sugjeron se është e nevojshme një analizë në lidhje me efektivitetin e marrëveshjeve të lidhura.


#### **Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

### **Vlerësimi sipas Standardeve**



Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardevë
<b>Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>GVJ konstatoi se KU IKT ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm , institucione publike apo kompani private, që mundësojnë ofrimin e praktikave mësimore profesionale për studentët.</p> <p>[Dok.Marrëveshjet e bashkëpunimit] [Takimi me studentët]</p>
<b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>KU IKT nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit dhe shkëmbimin e informacionit.</p> <p>KU IKT bën përpjekje në garantimin e një marrëdhënie të frytshme bashkëpunimit nëpërmjet ndarjes së detyrave dhe përgjegjësive, por nuk ka ende një analizë të vazhdueshme të bashkëpunimeve.</p>
<b>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>KU IKT për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas.</p> <p>KU IKT ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës [ dok. Marrëveshjet e bashkëpunimit] Institucioni nuk ka organizuar trajnime profesionale të mëtejshme [ dok.Kalendari i aktiviteteve] Aktualisht nuk ka një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale nga KU IKT.</p>
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b>	
<p>KU IKT ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet brenda dhe jashtë vendit dhe kompani dhe biznese vendase. Marrëveshjet janë në nivel institucioni, GVJ nuk mund ti ndajë ato që kanë lidhje direkte me këtë program studimi. GVJ mbështetur në RVB dhe nga takimet e zhvilluara, konstaton se nuk mund të përcaktohet qartë masa e përfitimit të bashkëpunimeve për programin Master i Shkencave në "Inxhinieri kompjuterike dhe teknologji informacioni", me tre profile, por kishte përpjekje zbatimin e tyre në lidhje me mobilitetet dhe kërkimin shkencor. GVJ konstaton se është aktiv bashkëpunimi me</p>	

komunitetin e biznesit dhe institucionet shtetërore dhe private në lidhje me praktikat profesionale të studentëve.



## ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Analiza përmbledhëse e RVJ sipas metodës SWOT (Strengths-pikat e forta, Weaknesses- pikat e dobëta, Opportunities-mundësitë, Threats-pengesat).

### a. Pika të forta:

1. Programi është në përputhje me strategjinë afatgjatë të institucionit dhe ka kurrikul bashkëkohore ndërkombëtare.
2. Institucioni përdor mjete efektive të vlerësimit të vazhdueshëm në lidhje me përmirësimin e mësimdhënies.
3. Institucioni përdor infrastrukturë moderne dhe bashkëkohore për leksione, praktika dhe laboratore
4. Orar fleksibël në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e studentëve.
5. Bibliotekë e pasur me libra në fushat përkatëse të studimit, regjistrim në një bibliotekë dixhitale dhe anëtarësim në revista shkencore;
6. Mbështetje ndaj “klubeve studentore” prej institucionit dhe Fakultetit të Inxhinierisë


### b. Pika të dobëta:

1. Cilësia e studentëve të rregjistruar në këtë program studimi.
2. Numër i vogël i stafit akademik të brendshëm
3. Mbulimi i ngarkesës mësimore jo në masën 70 % të saj nga stafi akademik i brendshëm.
4. Mungesa e përfshirjes së studentëve në veprimtarinë kërkimore – shkencore.
5. Institucioni ka rezultuar me humbje financiare. E ardhmja financiare varet nga financimi nga ortaku.

### c. Mundësitë:

1. Përmirësimi i cilësisë në hyrje i studentëve master.
2. Rritja e kapaciteteve të brendshme akademike.
3. Marrëdhënia e studentëve të diplomuar me institucionin edhe mbas përfundimit të studimeve.
4. Mësimdhënie në gjuhën angleze që favorizon mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik.
5. Ofrimi i bursave për të tërhequr studentë më cilësorë.
6. Kërkesa e vazhdueshme e tregut të punës për specialistë në fushat e programit të studimit.
7. Përfshirja në projekte për të siguruar të ardhura shtesë për mbulimin e shpenzimeve.

### d. Pengesat:





1. Konkurrenca nga hapja e programeve të ngjashme në IAL të tjera private apo publike
2. Problemet e të gjithë rajonit në fushën e zhvillimit të Arsimit të Lartë cilësor dhe kërkimit shkencor.

**Rekomandime:**

1. Te rritet cilesia e studenteve ne hyrje
2. Te perfshihen studentet ne kerkimin shkencor
3. Te rritet numri i stafit akademik te brendshem
4. Te rritet numri i aplikimeve per projekte dhe grante kombëtare dhe ndërkombëtare që të sigurohet qëndrueshmëria financiare

**Ekspertet e vlerësimit të jashtëm:**

Prof. Asoc. Elinda Kajo Mece



Prof. Asoc. Ana Ktona



## ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Analiza përmbledhëse e RVJsipas metodës SWOT(Strengths-pikat e forta, Weaknesses- pikat e dobëta, Opportunities-mundësitë, Threats-pengesat).

### a. Strengths:

1. The program is consistent with the CIT's long-term strategy and has contemporary international curricula.
2. The institution uses effective continuous assessment tools with respect to teaching' improvements.
3. The institution uses modern and contemporary infrastructure for lectures, practices, and laboratories.
4. Flexible timetable tailored to the needs and requirements of students
5. The library is rich with books in the relevant fields of study, registration in a digital library and membership in scientific journals;
6. Support to "student clubs" from the Institution and Faculty of Engineering


### b. Weaknesses:

1. The quality of students enrolled in this study program.
2. Small number of internal academic staff
3. Coverage of less than 70% of the teaching load by internal academic staff.
4. Lack of student involvement in scientific-research activity.
5. The institution has resulted in financial losses. The financial future depends on partner funding.

### e. Opportunities:

1. Improving quality of master students at the entrance in the program.
2. Increase of internal academic capacities.
3. Relationship of graduate students to the institution even after graduation.
4. Teaching in English that favors the mobility of students and Academic Staff;
5. Offering scholarships to attract more quality students.
6. Continuous job market demand for specialists in the fields of study program.
7. Involvement in projects to provide additional revenue to cover the costs.

### f. Threats:



1. Competition from the opening of similar programs at other private or public Higher Education Institutions.
2. The problems of the entire region in the field of development of a qualitative Higher Education and scientific research.

**Recommendations:**

1. Increase the quality of students at the entrance
2. Increase the number of internal academic staff
3. Include students in scientific research
4. Increase the number of applications for national and international projects and grants to provide financial sustainability

**External Evaluation Group:**

Prof. Asoc. Elinda Kajo Mece



Prof. Asoc. Ana Ktona

